

AKT THEMELIMI DHE STATUTI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"WELLNESS ALBANIA CLINIC" sh.p.k

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
WELLNESS ALBANIA CLINIC SH.P.K.**

Sot ne daten 01.10.2023 bazuar ne ligjin Nr. 9901 "Per Tregtaret dhe shoqerite Tregtare" i ndryshuar dhe ne ligj Nr.9723, date 03.05.2007 "Per regjistrimin e biznesit" i ndryshuar, themeluesi: **QENDRA E MJEKESISE SE PUNES SH.P.K.**, e regjistruar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit me numer NIPT: L91325020J, me seli ne adresen Residencia Olimpikë, Rruga "Prokop Mirna", Hyrja 1, Kt. 1, Tirane, e perfaqesuar nga **Znj. Ariana SINA**, e bija e Hamdi dhe Marika, e dtl. 03.02.1978, e identifikuar me nr. personal H85203066V dhe **Znj. Irena KITA**, e bija e Andreas dhe Jollandes, e dtl 03.01.1982, e indentifikuar me nr. personal 125103049A, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar vendosen te krijojne shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne cilesine e Administratoreve, redaktuan dhe nenshkruan Aktin e Themelimit dhe Statutin e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar

VIVIEN MEDICAL sh.p.k, me numer NIPT M02403020L, me seli ne: Tirane, Njesia Administrative Nr. 8, Rruga Zef Jubani, Njesia administrative, nr. 5, ndertesa 15, hyrja 9, ap. 43, Tirane, e perfaqesuar nga **Z. Olsi ZOTO**, i biri i Adriatik dhe Elida, me nr. Personal J10325120D, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar vendosi te krijojne shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, redaktoi dhe nenshkroi Aktin e Themelimit dhe Statutin e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar Wellness Albania Clinic sh.p.k. me poshte vijon:

Kreul

THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHEZGJATJA, SELIA


Neni 1

Emri, Data e Themelimit dhe Themeluesit

11 Emri i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar eshte "**WELLNESS ALBANIA CLINIC**" sh.p.k. (me poshte e quajtur "Shoqeria") e cila eshte themeluar me daten 01/10/2023.

12 Shoqeria **WELLNESS ALBANIA CLINIC sh.p.k.**, themelohet nga ortaket e shoqerise:

QENDRA E MJEKESISE SE PUNES SH.P.K., e regjistruar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit me numer NIPT: L91325020J, me seli ne adresen Residencia Olimpikë, Rruga "Prokop Mirna", Hyrja 1, Kt. 1, Tirane, e perfaqesuar nga **Znj. Ariana SINA**, e bija e Hamdi dhe Marika, e dtl. 03.02.1978, e identifikuar me nr. personal H85203066V dhe **Znj. Irena KITA**, e bija e Andreas dhe Jollandes, e dtl 03.01.1982, e indentifikuar me nr. personal 125103049A, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar vendosen te krijojne shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne cilesine e Administratoreve, redaktuan dhe nenshkruan Aktin e Themelimit dhe Statutin e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar


2

VIVIEN MEDICAL sh.p.k, me numër NIPT M02403020L, me seli në: Tiranë, Njësia Administrative Nr. 8, Rruga Zef Jubani, Njësia administrative, nr. 5, ndërtesa 15, hyrja 9, ap. 43, Tiranë, e përfaqësuar nga Z. Olsi ZOTO, i biri i Adrijatik dhe Elida, me nr. Personal J10325120D, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar vendosi të krijojë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, redaktoi dhe nënshkroi Aktin e Themelimit dhe Statutin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar Wellness Albania Clinic sh.p.k.

Adresa Zyrtare e-mail i shoqërisë do të jetë adresa Rezidenca Olimpikë, Rruga "Prokop Mima", Hyrja 1, Tiranë

- Numri i Kontaktit të Shoqërisë do të jetë: +355 697009090

Neni 2

Objekti

- 2.1 Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen e të gjitha aktiviteteve që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke u fokusuar kryesisht në:
1. Ofrim i shërbimeve mjekësore nga mjekët specialistë;
 2. Ofrimi i ekzaminimeve mjekësore, kimike, biokimike, hormonale etj;
 3. Konsulencë dhe këshillime të ndryshme mjekësore;
 4. Trajnime që kanë të bëjnë me shëndetin;
 5. Shoqëria mund të marre pjesë në konkurse, oferta, inicitiva private, procedurave të negociuara, ankande, tendera, kontrata, procedurat për financimin e projektit, të organizuara nga instimcionet shtetërore dhe publike nga kompani private apo kontraktuese të përgjithshme, organizata, biznese.
 6. Shoqëria gjithashtu mund të ketë pjesëmarrje dhe interesa në shoqëri apo ndërmarrje të tjera, të cilat kanë objekt të ngjashëm, të përafërt ose të lidhur me objektin e shoqërisë, të cilat konsiderohen të nevojshme ose të dobishme për përmbushjen e objektit të shoqërisë.
 7. Import-Eksport, tregti me shumicë e pakicë të të gjitha llojeve të mallrave mjekësore, artikuj farmaceutike, si dhe cdo lloj materiali të lejuar nga legjislacioni shqiptar në fuqi për këte lloj shoqërie.

- 2.2 Për të realizuar objektin e aktivitetit të saj, Shoqëria mund të veprojë në Shqipëri dhe jashtë saj dhe të kryejë çdo aktivitet tjetër të lidhur, ndihmës me qëllim të përmbushje ose të jetë i dobishëm për përmbushjen e objektit të saj.

Neni 3

Kohëzgjatja

- 3.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një afat të pacaktuar dhe mund të shpërbëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkak.

Neni 4

Selia

4.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën : Rezidenca Olimpikë, Rruga "Prokop Mima", Hyrja 1, Tiranë.

4.2 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë mbi transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjetër. Organi administrues i Shoqërisë mund të themelojë ose mbyll degë dhe/ose zyra përfaqësimi, brenda apo jashtë Republikës së Shqipërisë.

Kreu II

KAPITALI

Neni 5

Kapitali i Shoqërisë

5.1 Kapitali themelues i Shoqërisë është 100 000.00 (njëqind mijë) lekë, në kontribute e shprehur në 2 kuota të kontribuara nga ortakët, në vlerën monetare 70 000.00 (shtatëdhjetë mijë) lekë dhe 30 000.00 (tridhjetë mijë) lekë. Kapitali i Shoqërisë nënshkruhet menjëherë dhe do të paguhet nga ortakët e shoqërisë që zotërojnë **QENDRA E MJEKËSISË SË PUNËS SH.P.K., 70 % (shtatëdhjetë përqind) dhe VIVIEN MEDICAL sh.p.k., 30% (tridhjetë përqind) të kontributeve në kapitalin e shoqërisë, përkatësisht nga:**

QENDRA E MJEKËSISË SË PUNËS SH.P.K., e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit me numër NIPT: L91325020J, me seli në adresën Residenza Olimpikë, Rruga "Prokop Mima", Hyrja 1, Kt. 1, Tiranë, e përfaqësuar nga **Znj. Ariana SINA,** e bija e Hamdi dhe Marika, e dtl. 03.02.1978, e identifikuar me nr. personal H85203066V dhe **Znj. Irena KITA,** e bija e Andreas dhe Jollandës, e dtl 03.01.1982, e indentifikuar me nr. personal I25103049A, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në cilësinë e Administratorëve, **zotëron 70 % (shtatëdhjetë përqind), të kontributeve në kapitalin e shoqërisë;**
dhe

VIVIEN MEDICAL sh.p.k, me numër NIPT M02403020L, me seli në: Tiranë, Njësia Administrative Nr. 8, Rruga Zef Jubani, Njësia administrative, nr. 5, ndërtesa 15, hyrja 9, ap. 43, Tiranë, e përfaqësuar nga **Z. Olsi ZOTO,** i biri i Adriatik dhe Elida, me nr. Personal J10325120D, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në cilësinë e Administratorit, **zotëron 30 % (tridhjetë përqind), të kontributeve në kapitalin e shoqërisë.**

Neni 6

Zmadhimi dhe zvogëlimi kapitalit

6.1 Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit

themeltar për kontributet në para dhe me anët e kontributeve në natyrë nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

6.2 Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

6.3 Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendime në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit. Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

7.1 Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) Kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) Shit-blerjes;
- c) trashëgimisë;
- d) dhurimit;
- e) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

7.2 Pjesë të kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, përsa nuk parashikohet ndryshe në statut. Pjesë të kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimarrës

8.1 Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çëshjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj

- pike;
- f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

8.2 Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

8.3 Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

9.1 Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

9.2 Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10

Kuorumi

10.1 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 përqind të kuotave.

10.2 Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë përçëshje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

10.3 Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuoromit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

11.1 Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

11.2 Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës për çështje të tjera si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin eshpërblimeve;
- e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecucisë së veprimtarisë;
- f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedime të tjera ndaj administratorëve;
- g) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë.

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 12

Përgjithshmi nga e drejta e votës

12.1 Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- d) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

12.2 Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13

Administrimi

- a) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 2 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje: Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- b) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo

emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

- c) Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator: Z. Olsi Zoto i cili do të ushtrojë kompetencat për një periudhë 2 (dy) vjeçare duke filluar nga data e nënshkrimit të këtij akti.

Neni 14

Kompetencat e Administratorit/ëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) Kryejnë të gjitha veprimet e administrimit, të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) Përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet përshpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente për para asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryejnë regjistrime dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- g) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçëm e me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut

Administratori është i detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detytimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim;
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë; që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë veç e veç ose bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15

Përgjegjësitë e Administratorit/ëve


15.1 Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera, gjatë administrimit të shoqërisë.

15.2 Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.


15.3 Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

1.

- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë të ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
 - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - d) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
 - e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standarteve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë,
4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:
- a) U kthen ortakëve kontributet;
 - b) U paguan ortakëve interesa apo dividendë;
 - c) U shpërndan aktivet shoqërisë;
 - d) Lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi pagueuse për të shlyer detyrimet;
 - e) Jep kredi.



9



15.4 Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

15.5 Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë-padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Neni 16

Vula

16.1 Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme, me logon dhe tekstin brenda saj.

Kreu IV

VITI FINANCIAR DHE EKSPERTËT

Neni 17

Viti Financiar

17.1 Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përgjatë vitit, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Neni 18

Kontrolli Financiar

18.1 Kontrolli financiar i Shoqërisë kryhet në përputhje dhe sipas legjislacionit shqiptar në fuqi. Asambleja e Përgjithshme do të emërojë një apo më shumë Ekspertë Kontabël të Autorizuar në ato raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet në bazë të ligjit.

Neni 19

Ekspertët

19.1 Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko-tregtare të shoqërisë, atë vjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

19.2 Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për n_jerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Neni 20

Bilanci vjetor

20.1 Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, inventari, raportet e Administratorit dhe të Ekspertit Kontabël të Autorizuar (nëse janë emëruar) miratohen nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori i paraqet për miratim Asamblesë së Përgjithshme raportin mbi administrimin e Shoqërisë si edhe llogaritë vjetore.

Neni 21 Dividenti

21.1 Pasi të jenë përmbushur kërkesat e përcaktuara nga Ligji "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Shoqëria, mund të vendosë shpërndarjen e dividendëve në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.

Kreu V PRISHJA- RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

Neni 22 Prishja dhe likuidimi

22.1 Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) Kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) Me vendim të Asamblesë së Ortakëve;
- c) Me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) Nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" i ndryshuar;
- e) Me vendim të gjykatës.

22.2 Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

22.3 Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.

22.4 Nëse Ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 23 Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja

23.1 Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën I të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

Neni 24
Baza Ligjore

24.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 25
Mosmarrëveshjet

25.1 Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lind midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 26
Zbatimi i kuadrit ligjor

26.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë Akt Themelimi e Statut si dhe ligjin shqiptar. Për sa nuk është parashikuar në këtë dokument, do të zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar në fushën e shoqërive tregtare.


Akt themelimi dhe statuti i shoqërisë u përpilua në katër kopje, për t'jua shpërndarë organeve kompetente dhe një kopje do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë "Wellness Albania Clinic" sh.p.k.

ORTAKËT E SHOQËRISË

QENDRA E MJEKËSISË SË PUNËS SH.P.K.

Arjana SINA

Irena KITA



VIVIEN MEDICAL SH.P.K.

Olsi ZOTO

